



VENDIM

Nr. 29 Datë 15.02.2017

MBI

**MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KOMP ENERGJI”
SH.P.K., ME NUMËR 253, SERIA T14P, MIRATUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE NR.102, DATË 07.11.2014, PËR
TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, pika 1 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së Nr. 840, datë 11.06.2008 “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Vinjoll”; nenit 15 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin nr. 109, datë 29.06.2016, të Bordit të ERE; nenit 8, të Kontratës Koncesionare, nr. 2807 Rep, dhe nr. 371 Kol, datë 01.09.2009; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.02.2017, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut në lidhje me modifikimin e licensës së aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë Komp Energji sh.p.k.,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Komp Energji” sh.p.k ka kryer pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit siç përcaktohet në aneksin “A” të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe pagesën e rregullimit për vitin 2015 dhe rezulton i çliruar nga çdo lloj detyrimi financiar ndaj ERE-s.
- Shoqëria “Hidropowerplant Construction” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar sipas nenit 9 (Formati dhe dokumentacioni për aplikim) të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë licencën e Tregimit të Energjisë Elektrike, me numër 253, seria T14P, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 102, datë 07.11.2014, duke zëvendësuar emrin e shoqërisë së licensuar “Komp Energji” sh.p.k., me shoqërinë “Hidropowerplant Construction” sh.p.k.
2. Të njoftohet shoqëria “Komp Energji” shpk, që të depozitojë në ERE, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, licensën e tregimit, me numër 253, seria T14P, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr.102, datë 07.11.2014.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI